



Komisioni për Implementimin e Rindërtimit
për lokacionet religjioze Ortodokse në Kosovë

KOMUNIKATË PËR SHTYP – 17 tetor 2006

PUNËT E RINDËRTIMIT JANË DUKE SHKUAR MIRË NË SHTATË LOKACIONE



Zyra e Sekretariatit të KIE në Kosovë, Ndërtesa UNHCR HQ, kati i 6, Kragujevci 8, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel : +381 (0) 38 243- 749 / 750 / 751 - Fax : +381 (0) 38 243 752

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Dhoma 132, Nëna Terezë Nr. 35, Prishtinë, 10000, Kosovë
Tel: +381 (0)38 20022- 054 / 059/ 073 - Fax: +381 (0)38 200 220 62



Komisioni për Implementimin e Rindërtimit
për lokacionet religjioze Ortodokse në Kosovë

Korniza e re nga çeliku qëndron mbi muret e Shën Gjergjit, Prizren

Komisioni për Implementimin e Rindërtimit (KIR) është i kënaqur që të njoftoj se punët janë duke ecur sigurt në shtatë lokacione kryesore të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë. Në Prizren, kulmi i ri dukshëm është duke marrë formën mbi muret e Kishës Peshkopale të Shën Gjergjit, dhe skelet tashmë kanë rrethuar kambanoren e Kishës së Virgjëreshës së Shenjtë Ljeviska me përparimin e punëve të konservimit në këtë vend që së voni është dezignuar si lokacion i trashëgimisë botërore UNESCO. Në Prishtinë, punët e plota të rindërtimit kanë filluar në Kishën e Shën Nikollës dhe ndërtesat e saja përfshijnë shtëpinë e priftërinjve, vendin e pagëzimit, dhe kullën e kambanës.

Puna është rezultat i përkrahjes dhe zotimit që i është dhënë KIR nga Kisha Ortodokse Serbe, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, IPM Kosova dhe Serbia dhe nuk do të ishte e mundur pa zotimin financiar të bërë nga IPVQ. KIR do të vazhdojë programin e vet të aktiviteteve rindërtuese përgjatë vitit 2007 dhe do të përmbushë të gjitha përgjegjësitë e veta deri në fund të dhjetorit 2007.

Komisioni Evropian dhe Këshilli i Evropës kanë investuar shumë në projekt me përkrahje të fortë administrative të UNMIK-ut. Agjencia Evropiane e Rindërtimit do të financojë dhe rindërtoj Rezidencën Peshkopale dhe ndërtesat e seminarit në Prizren në vitin 2007, një program i cili përkrah punën e KIR për vitin e ardhshëm.

Emma Carmichael
Kryesuese e KIR s



Zyra e Sekretariatit të KIE në Kosovë, Ndërtesa UNHCR HQ, kati i 6, Kragujevci 8, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel : +381 (0) 38 243- 749 / 750 / 751 - Fax : +381 (0) 38 243 752

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Dhoma 132, Nëna Terezë Nr. 35, Prishtinë, 10000, Kosovë
Tel: +381 (0)38 20022- 054 / 059/ 073 - Fax: +381 (0)38 200 220 62